Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllëgarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikimi i Materialeve:

Kodi ESHF F	Artikulli	Emërtimi Shqip	Emërtimi Botanik	Specifikimet teknike		Të dhëna të tjera
				Perimetri Ø / cm	Lartesia h / cm	
	A	DRURE DEKORATIVE				
01542	1	Bliri	Tilia cordata	36-40	700-800	Kurora në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjete) ≥ 80 cm
01542	2	Bliri	Tilia cordata	30-34	600-700	Kurora në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjete) ≥ 80 cm
01543	3	Bliri	Tilia argentea	20-24	500-600	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 80 cm

0250	4	Liridendro	Liriodendron tulipifera	30-34	600-700	Kurora në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjete) ≥ 80 cm
0181	5	Rrap	Platanus orientalis	26-30	600-700	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 80 cm
0181	6	Rrap	Platanus orientalis	16-18	300-400	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 70 cm
02243	7	Ligustër	Ligustrum vulgare	16-18	300-400	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 60 cm
0248	8	Likuidambar	Liquidambar styraciflua	36-40	600-800	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 80 cm
0194	9	Fotinja	Photinia fraseri "Red Robin"	18-20	250-300	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 60 cm
	B	SHKURRE DEKORATIVE				
0197	1	Nandina	Nandina domestica		>120	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 30 cm
0179	2	Oleander	Nerium oleander		>170	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 40 cm
0198	3	Evanymus	Euonymus		>30	Kurora në formën karakteristike të llojit, me Vazo ≥ 20 cm
0158	4	Bush glob	Buxus micropylla		>40	Kurora në formën karakteristike të llojit, me Vazo ≥ 25 cm
0195	5	Tuja forme	Thuja aurea nana		>90-100	Kurora në formën karakteristike të llojit, me bukë ≥ 35 cm

Për suportimin e detyrave dhe funksioneve Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjellbërimit të Qytetit si një ndër drejtoritë me funksionalitete të rëndësishme si pjesë e DPPGJ ka nevojë të domosdoshem për drurë dhe shkurre për mbjellje në zona të ndryshme të qytetit të cilat duhet të mbillen, shkulen dhe transporten deri tek autoriteti kontraktor sipas mënyrave të përcaktuara në keto specifikime teknike.

Bimësia dekorative (drurë_shkurre) dhe kompozimi në gjellbërim.

Në sipërfaqet e gjellbëra elementi bazë dhe faktori kryesor që përcakton kompozimin e tyre estetik mbetet gjithmonë bimësia dekorative që ka në përbërjen e saj drurët, shkurret, lulet dhe elementët e tjerë plotësues të gjellbërimit si, koshat për hedhjen e mbeturinave të çastit, stolat për pushim, shatërvane dhe çezma për freskim brenda këtyre sipërfaqeve.

Bimësia dekorative mund të lihet me rritje natyrore ose mund ti jepet edhe forma të rregullta sferike dhe gjeometrike, paralelepipedë, konike, etj.

Veçoritë e drurëve dekorativë:

- drurë me kurorë ovale; Bli, Lisi, etj.
- drurët me kurorë konike; Likuidambër, Rrapi, Bli, etj.

Megjithëse drurët në përgjithësi i kanë gjethet në ngjyrë jeshile, kjo nuk është e njëjlojtë për të gjitha llojet e drurëve, por ndryshon në nuancën e saj.

Sipas ngjyrës së gjetheve dallojmë:

- Drurë me gjethë jeshile të errëta, që në vjeshtë kalojnë në të verdha. Blinjtë, Panjat, Plepi i Kanadasë etj. Drurë me gjethë jeshile të qelta, që në vjeshtë kalojnë në të verdhë të

çelët; mështekna, bliri, akacia, sofra, panja negundo, rrapi etj.

- Drurë me gjethe bojçeqielli në jeshile që në vjeshtë kalojnë në ngjyrë të verdhë si të kuqe; ahu, panja, etj.

- Drurë me gjethe të verdha e jeshile të cilat në vjeshtë kalojnë në okër; mështekna, arra gështenja e butë etj.

Veçori të shkurreve dekorative

Sipas lartësisë ndahen në: shkurre të larta - mbi 3 metra; shkurre mesatare 1-3 metra; shkurre të ultë deri 1 metër.

Sipas formës së kurorës ndahen në: shkurre më kurorë ovale; jargavani, oleandri etj.; shkurre më kurorë konike; manjola, dëllinja, tisi etj.; shkurre me kurorë si çadër; dëllinja; shkurre me kurorë të hapur që është edhe pjesa më e madhe e tyre; shkurre me kurorë zvarranike, etj. Mjediset e gjelbëra kanë në përbërjen e tyre të gjithë drurët (pemët), shkurret dhe çdo lloj vegjetacioni tjetër që rritet në vende ku jetojnë, punojnë dhe kryhet aktiviteti njerëzor. Prioritet i shtimit të gjelbërimit është futja e bimësisë hibride dhe sidomos asaj autoktone (vëndase) me rritje të shpejtë dhe efekteve jo vetëm në aspektin dekorativ (zbukurues) por edhe në të gjitha të mirat e tjera në shërbim të plotë të komunitetit.

Në zgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë (pemë) dhe shkurre është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kryesorë:

a) Qëllimi i mbjelljeve,

b) Kushtet e mjedisit dhe

c) Veçoritë biologjike të llojit.

Me qëllimin që menjëherë mbas mbjelljes mjedisi të ketë atraksionin e duhur në tërësinë e vet dhe sidomos ndaj komunitetit, drurët dhe shkurret dekorative pëzgjidhen me karakteristika dendrometrike të avancuara, në vartësi kjo edhe të llojeve dhe kërkesave të tyre ndaj faktorëve klimatikë dhe edafikë.

Kështu preferohet që lartësia e trungut të drurëve (pemëve) duhet të jetë 2,5 deri 3.5m, lartësia e kurorës rreth 2 m, perimetri (cirkoferenca) në 1.30 m nga toka, duhet të jetë 14 deri 16 cm, kurora të jetë simetrike në formën karakteristike të llojit me buke dheu.

Kushtet e mjedisit janë përcaktuese për zgjedhjen e llojeve të përshatshme për rritje dhe zhvillim normal, në plotësim të kërkesave jo vetëm për krijimin e një peisazhi sa më atraktiv por edhe në fuksion të të mirave materiale komplekse për komunitetin.

Po kështu në përzgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë dhe shkurre mbahet parasysh përbërja dhe veçoritë biologjike të llojeve në përshtatje të plotë me bimësinë dekorative në një zonë të caktuar, në një bllok banimi apo gjelbërimi përgjatë rrugëve etj.

Në llojet e bimësisë së përzgjedhur ka një alternim midis bimësisë dekorative halorë, fletorë dhe shkurre, përherëblertë dhe gjetherënës, si dhe midis formave dhe koloreve, për të krijuar panorama dhe peisazhe të soditshëm dhe të ndryshueshëm në raport me ndryshimin e stinëve.

TEKNIKA E MBJELLJES SË DRURËVE DEKORATIVË

Në krijimin e sipërfaqeve të gjelbëra, për të mundur efekt të shpejtë dhe të parakohshëm, ka filluar të përdoret rëndom edhe mbjellja e drurëve dekorativë të rritur. Kjo teknikë presupozon mbjelljen e bimësisë dekorative më parë nga fidanishtja në vazo.

Kjo teknikë ka filluar të përdoret gjerësisht edhe në institucionin tonë. Kështu përdoret në gjelbërimitin e trotuareve të rrugëve të reja dhe të atyre të vjetra ku në radhën e drurëve ekzistues, duhen zëvendësuar drurë të veçantë, të cilët;

- si rezultat i veprimit të faktorit objektiv (që përfshin kushtet natyrore), vjetërohen, deformohen, rrëzohen etj., dhe po kështu;

- si rezultat i veprimit të faktorit subjektiv (që përfshin veprimtarinë e njeriut) dëmtohen tërësisht ose pjesërisht, me ose pa dashje, dhe humbasin kështu funksionin e tyre dekorativ si dhe prishin njëllojshmërinë e gjelbërimit kudo në tërësinë e vet, në rrugë e blloqe banimi, në sheshe e bulevarde, në lulishtet e qytetit, në lulishtet e institucioneve shtetërore, etj.

Para se të fillojme mbjelljen e pemëve në vazo, në fund të saj duhet të vendosim gurë, guralecë ose qeramikë të thyer për të parandaluar bllokimin e vrimave me dhe' dhe për të lejuar kullimin e lirë. Më pas brenda vazos hidhet toka, kjo duhet të sigurojë ajrim dhe kullim të mjaftueshëm duke ruajtur sasi të përshtatshme lagështie. Për qëllime të përgjithshme do t'i sigurojë të gjitha këto dhe mund të plotësohet edhe me plehra organike. Pema e mbjellë në këtë vazo nuk është në gjendje t'i përhapë rrënjët e saj për të arritur ujin, prandaj është e domosdoshme ta ujisim pemën rregullisht. Në këtë rast uji i freskët i shiut është më i miri.

Nëse jemi të detyruar që pemën nuk mund ta mbjellim në tokë brenda vitit por do ta mbajmë më shumë, atëherë duhet të sigurohuni që pema të jetojë në rehati duke rifreskuar shtratin e saj çdo vit. Këtë veprim mund ta bëjmë duke hequr dheun e sipërm të lirshëm dhe duke e zëvendësuar atë me dhe' të pasur me pleh.

Epërsitë e kesaj metode janë

- Zënie e garantuar dhe zhvillim normal i procesit jetësor të drurëve dhe shkurreve.
- Transport i lehtë dhe i shpejtë në objektet e mbjelljes.
- Heqje e shpejtë dhe mbjellje e lehtë e bimësisë dekorative në gropat e hapura më parë.

Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vegjël, prandaj ky proces kërkon punonjës dhe punëtorë me nivel të lartë kualifikimi, mjete të posaçme të shkuljes, ambalazhimit, ngarkimit në makineri,

transportit deri në objekt, shkarkimin dhe deri mbjelljen e tyre duke zbatuar rigorozisht teknikën e domosdoshme.

SHKULJA E DRURËVE

Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi 1.30 m (afërsisht në lartësinë e gjoksit të njeriut) nga toka. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, piramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trugu i pemës.

Gjatë shkuljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rrënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura. Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, pasi kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Pasi të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, Pasi të ketë përfunduar mbështjellja e bukës së dheut bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasur parasysh madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulen.

TRANSPORTIMI I DRURËVE

Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pasha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinç. Me qëllim të gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.

Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që buka e dheut të shtrihet në pjesën e karrocërisë së automjetit. Duhet theksuar se aty ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinç. Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisat për në vendin e mbjelljes edhe vinçi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me rrogozë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulen, transportohen e mbillen kur temperatura zbret në (-10 grade). Për një mbjellje të suksesshme dhe ecuri normale vegetative është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po ne atë drejtim. Mosrespektimi i këtij kushti shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurorës së fidanit.

MBJELLJA E DRURËVE

Koha e përshtatshme për mbjellje. Drurët dhe shkurret zakonisht mbillen vetëm gjatë periudhës së pushimit të vegetacionit, pikërisht atëherë kur proceset jetësore të tyre zvogëlohen në minimum.

Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja. Në varësi të përmasave të bimësisë së kërkuar hapet dhe gropa, konkretisht për drurë (pemë) me përmasa të diametrit deri 5 cm dhe bukë dheu 50 cm, gropa hapet me përmasa 80x80x80cm. Fidani (druri_pema) vendoset përpjendikularisht, 30-40 cm mbi dheun e hedhur paraprakisht në gropë, i cili duhet të jetë dhe' i mirë vegjetal dhe pa gurë apo inerte, druri mbahet drejt nga një punëtor dhe nga dy punëtorët e tjetër fillohet të mbushet nga të gjitha anët me dhe' i cili vazhdimisht ngjishet me këmbë, si në figurën e mëposhtme (figura nr.1).

Në përfundim të procesit duhet të ujitet me ujë të bollshëm. Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe' rreth e përqark saj formohet një unazë dheu e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë ujitjes dhe reshjeve të shiut. Këtë ujë fidani (druri_pema) do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë.

Per objektin ne reference.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, DPPGJ, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

SHËRBIMET PAS MBJELLJES

Është e domosdoshme që vitin e parë pas mbjelljes, bimësia dekorative drurë dhe shkurret duhet të ujitin rregullisht çdo tre ditë. Toka poshtë kurorës duhet të shkrihet e prashitet, kurse gjatë verës kur temperatura është e lartë është e nevojshme që t'u bëhet edhe vaditja e spërkatja me ujë e kurorës.

KARAKTERISTIKAT DENDROMETRIKE PËR DISA LLOJE DRURË DHE SHKURRE

1. Bli, (*Tilia cordata*), (me diameter 36-40 cm në 1.3 m nga toka)
2. Bli, (*Tilia cordata*), (me diameter 30-34 cm në 1.3 m nga toka)
3. Bli, (*Tilia argentea*), (me diameter 20-24 cm në 1.3 m nga toka)
4. Liriodendron (*Liriodendron tulipifera*), (me diameter 30-34 cm në 1.3 m nga toka)
5. Rrap (*Platanus orientalis*) (me diameter 26-30 cm në 1.3 m nga toka)
6. Rrap (*Platanus orientalis*) (me diameter 16-18 cm në 1.3 m nga toka)
7. Liquidambar (*Liquidambar styraciflua*), (me diameter 36-40cm në 1.3 m nga toka)
8. Ligustër peme (*Ligustrum vulgare*), (me diameter 16-18 cm në 1.3 m nga toka)

Shkurre

9. Bush (*Buxus micropylla*) Boxwood, h më e madhe se 40cm
10. Oleandër, (*Nerium oleander*), h më e madhe se 170 cm
11. Nandia (*Nandina domestica*), h më e madhe se 120 cm
12. Evanymus (*Evanymus europaeus*) h më e madhe se 30cm
13. Tuja formë (*Thuja aurea nana*) h më e madhe se 90 cm
14. (Fotinja), *Photinia fraseri* "Red Robin" (*Ligustrum vulgare*), (me diameter 18-20 cm në 1.3 m nga toka)

Shënim: Në lidhje me emërtesat e çdo marke ose/dhe standarti, të përmendur më lart, Autoriteti Kontraktor pranon edhe ekuivalentet e tyre.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

“DRURE DHE SHKURRE DEKORATIVE”

Artikulli	Emërtimi Shqip	Emërtimi Botanik	Njesia	Sasia
A	DRURE DEKORATIVE			
1	Bliri	Tilia cordata	Copë	30
2	Bliri	Tilia cordata	Copë	100
3	Liridendro	Liriodendron tulipifera	Copë	20
4	Rrap	Platanus orientalis	Copë	50
5	Bliri	Tilia argentea	Copë	300
6	Ligustër	Ligustrum vulgare	Copë	200
7	Liquidamber	Liquidambar styraciflua	Copë	100
8	Rrap	Platanus orientalis	Copë	300
9	Fotinja	Photinia fraseri "Red Robin"	Copë	50
	Total - A			
B	SHKURRE DEKORATIVE			
1	Nandina	Nandina domestica	Copë	250
2	Oleander	Nerium oleander	Copë	500
3	Evanymus	Euonymus	Copë	300
4	Bush glob	Buxus micropylla	Copë	900
5	Tuja forme	Thuja aurea nana	Copë	200
	Total - B			
	Total (A + B) pa tvsh			

Afatet e lëvrimit: Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër 12 mujore.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarim, sipas shtojcës 9)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik

është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009(të ndryshuar) atëherë bilanci duhet të shoqërohet edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës/ava që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, me një numër prej mesatarisht 13 (trembëdhjetë), punonjës të punësuar për periudhën 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, përfshirë dhe stafin e mëposhtëm :

1 (një) “Agronom i lartë”, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Diplomë me profesion Agronom i lartë;
- Kontratë pune (e vlefshme);
- Librezë pune
- CV-në përkatëse

Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik agronom të lartë i cili duhet të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik me kohë të plotë pune dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera me qëllim që të ndjekë procesin e mirëmbajtjes dhe dorëzimit të bimësisë dekorative tek Autoriteti kontraktor.

2 (dy) automakinistë, duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Kontratë pune (e vlefshme).
- Leje drejtimi (e vlefshme).
- Librezë pune
- Dëshmi e aftësisë profesionale/patente e lëshuar nga “Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” (e vlefshme).
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuar nga IQT/ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të (e vlefshme).

3 (tre) shofer , duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Kontratë pune (e vlefshme).
- Leje drejtimi (e vlefshme).
- Librezë pune
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të leshuar nga IQT/ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të (e vlefshme).

1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Kontratë pune (e vlefshme).
- Librezë pune
- Diplomë/certifikate sipas ligjit Nr. 15/2017.
(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës " Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

6 (gjashtë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për "Punime në fidanishte" duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Kontratë pune (e vlefshme).
- Librezë pune
- Diplomë/certifikate sipas ligjit Nr. 15/2017.

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin e kërkuar në pikën 2.3.2 që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Tabela 1

Emer Mbiemer i Punonjësit	Nr Identifikimi (ID/Letërnjoftim)	Profesioni	Institucioni Publik/Privat Lëshues i Certifikatës/Diplomës	Nr NIPT i Institucionit (nëse privat)

Dhe

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025 për periudhën e mesipërme.
- Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesipërme.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, si dhe me plotësimin e formatit të deklaratës sipas Tabeles 1

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon një ambient të specializuar për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e bimëve (fidanishte), me sipërfaqe jo më të vogël se 5.000 m², të pajisur me sistem ujitjeje dhe plehërimi.

Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë çdo dokument që provon të drejtën e pronësisë apo posedimit të ligjshëm mbi ambientin (si certifikatë pronësie, kontratë shitblerjeje, dhurimi, qiraje, huapërdorjeje, vendim gjykate etj.), në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, duhet të dorëzohen fotografi të ambientit dhe një deklaratë angazhimi ku operatori merr përsipër të mirëmbajë bimët në kushte optimale deri në dorëzimin të autoriteti kontraktor, sipas specifikimeve teknike të kontratës.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi:

- Çertifikate zyrtare model 3, të aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certifikate zyrtare model 3 të aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative)

ose

- Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim prodhuesi/distributori për furnizimin nga subjekti importues ku duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, shoqëruar me një deklaratë (nga subjekti importues) që në momentin e furnizimit me drurit dhe shkurret dekorative (sipas sasise dhe specifikimeve teknike) do shoqërohen me “ Çertifikate Fitosanitare “ nga shteti importues, e cila vërteton pastertinë gjenetike bimes.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogë, fragmente katalogësh, broshura ose skeda teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi, ku të identifikohen qartësisht produktet e ofertuar dhe modelet përkatëse.

Katalogët ose broshurat duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të secilit artikull, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST). Ky dokumentacion shërben për të bërë të mundur krahasimin e specifikimeve të mallit të ofertuar me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor.

Dokumentacioni teknik duhet të jetë i hartuar në gjuhën zyrtare të përcaktuar në DST. Në rastet kur është në një gjuhë të huaj, duhet të shoqërohet me përkthim zyrtar në gjuhën e pranueshme nga autoriteti kontraktor, në përputhje me kërkesat e përgjithshme të DST-së.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës duhet të provojë disponimin (në pronësi ose me qira) të mjeteve të nevojshme për transportin dhe shkarkimin e mallrave në vendet e përcaktuara për furnizim nga autoriteti kontraktor, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton .	Copë	1	Pronësi ose me qira
2	Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton.	Copë	2	Pronësi ose me qira
3	Kamion me vinç (kapaciteti mbajtës minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton) .	Copë	2	Pronësi ose me qira

Për mjetet në pronësi, operatori duhet të paraqesë: a) dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë të kontrollit teknik (*të vlefshme*); d) siguracion mjeti (*i vlefshëm*); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (*sipas Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998*).

Për mjetet me qira: a) kontratë noteriale qiraje (*e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës*); b) akt pronësie i mjetit; c) leje qarkullimi; ç) certifikatë e kontrollit teknik (*e vlefshme*); d) siguracion (*i vlefshëm*); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (*në përputhje me Ligjin nr. 8378/1998*).

Operatori duhet të paraqesë deklaratë për vendndodhjen e mjeteve dhe deklaratë për pranimin e verifikimit të tyre nga autoriteti kontraktor në çdo kohë deri në përfundim të kontratës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin një deklaratë për marrjen përsipër të transportit dhe dorëzimit të drurëve dhe shkurreve dekorative, sipas kërkesave dhe në vendin e caktuar nga autoriteti kontraktor.

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalentin e saj, që lidhet me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe që mbulon drejtpërdrejt objektin e kësaj procedure prokurimi. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës dhe e lëshuar nga një organ vlerësimi të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë, ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur zyrtarisht nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, është e domosdoshme që çdo anëtar i bashkimit, që merr përsipër furnizimin për një pjesë të kontratës, të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

